

Veprimtaria 1.1/11: «Informimi – Shërbimi i shtetasve të vëndeve të tretë që banojnë në mënyrë të ligjshme në shtetin tonë»
Vepra 1.1.a./11: «Hapja e zyrave të mbështetjes ligjore dhe administrative dhe prodhim materiali informues të shkruar dhe elektronik për çështje ligjore dhe administrative në lidhje me shtetasit e vëndeve të tretë»

Je emigrant i ligjshëm?

Në këtë botim mund të gjeësh informacione të vlefshme për një sërë temash, si rinovimi i lejes së qëndrimit për punë të varur, se si do të llogaritet ditët e sigurimit që kërkohen për rinovimin e lejes së qëndrimit, ç'farë duhet që të marrësh lejet afatgjata, shtetësinë dhe të sigurosh certifikimin e mësimit të mjaftueshëm të gjuhës, të historisë dhe kulturës, si edhe për denoncimin në Autoritetet të incidenteve të dhunës raciste ose diskriminimeve kundër teje.

Për informacione më të hollësishme mund të kërkosh në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme (www.ypes.gr) si edhe në faqen e internetit të veprimtarisë sonë (www.mighelp.net).

Gjithashtu mund të dërgoni pyetjet tuaja në adresën elektronike contact@mighelp.net

Rinovimi i lejes për punë të varur

Me qëllim që të rinovosh lejen e qëndrimit për punë të varur, duhet të njohësh të mëposhtmet:

Afati i dorëzimit të kërkesës: Dy muaj para datës së skadimit të lejes së qëndrimit.

Kërkesa për rinovimin e lejes së qëndrimit mund të dorëzohet edhe deri një muaj pas kalimit të afatit, por do të paguash gjjobë 50 euro

Në qoftë se ka kaluar një muaj nga skadimi i lejes së qëndrimit, humbet të drejtën e rinovimit. Zgjidhje e vetme në këtë rast është të bësh kërkesë për arsye të jashtëzakonshme në Ministrinë e Brendshme.

Ku dorëzoi kërkesën: Në Bashki, përveç rastit kur funksionon në zonën ku banon Shërbimi i një Stacioni (mund të informohesh nga Bashkia). **Kuotë (paravolo) :** 300 euro (150 për çdo vit)

Dokumente

- Kontratë pune, përveç rasteve kur nga natyra e punës tënde (shumë punëdhënës, të punësuar sezonalisht në turizëm që marrin subvencion pune), përjashtohesh.
- Vërtetim i përbushjes së detyrimeve fiskale.
- Vërtetime sigurimi, në mënyrë analoge me subjektin e sigurimit.
- Fakte vërtetuese për rastin e mungesës së justifikuar nga puna (papunësi, sëmundje etj).
NUK LLOGARITEN DITËT E MUNGESËS NGA VENDI.

Procedura

Bashkia kontrollon **plotësinë** e dokumenteve dhe dërgon dosjen në Shërbimin për të Huajt të Prefekturës, brenda pesëmbëdhjetë ditëve.

Vërtetimi

*Në qoftë se dorëzon dokumente të **plota**, Shërbimi të jep vërtetim dorëzimi (ngjyrë blu), i cili ka afat për një vit dhe rinovohet çdo herë për një vit deri sa ti jepet përgjigje kërkesës tënde. Në qoftë kërkesa tënde refuzohet, atëherë pushon automatikisht edhe fuqia e vërtetimit.*

Ke të drejtën të marrësh vërtetimin akoma edhe në qoftë se:

1. ka skaduar pasaporta tënde dhe paraqet vërtetim nga ambasada e shtetit tënd se ke bërë kërkesë për pasaportë të re.
2. je i papunë dhe paraqet vërtetimin e regjistrimit në regjistrat e të papunëve (kartë papunësie) kundrejt kontratës së punës

Në këto raste duhet të paraqesësh pasaportë të re dhe kontratë pune brenda gjashtë muajve.

Me vërtetimin je i ligjshëm në Republikën Hellene, por nuk mund të udhëtosh jashtë vendit, me përjashtim atdheun tënd (përveç rasteve kur ke të drejtën për një gjë të tillë për arsye të tjera).

Për informacione analitike mund të vizitosh faqet e internetit www.mighelp.net dhe www.ypes.gr

Sa ditë sigurimi kërkohen për rinovimin e lejes së qëndrimit (par. A1 Y.A.15055/546, Fleta e Gazetes Zyrtare t. B´ 1886/25.8.2011)

Në qoftë se je i siguruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore – **IKA**, (punë e varur ose ofrim shërbimesh/vepre) duhet të kesh 120 pulla ditësh sigurimi në vit ose 240 totalisht në dyvjeçar.

Në qoftë se je i siguruar në Organizmin e Sigurimeve Bujqësore – **OGA** (si punëtor fushe ose rrogëtar) duhet të kesh sigurim 6 muaj në vit.

Në qoftë se je i siguruar në Organizmin e Sigurimeve të Profesionistëve të Lirë – **OAEE** (ofrim shërbimesh / vepre) duhet të kesh sigurim 250 ditë në vit ose 500 totalisht në dyvjeçar.

Në qoftë se je i siguruar në Organizmin e Sigurimeve të Profesionistëve të Lirë – **OAEE** (veprimtari e pavarur) duhet të kesh sigurim 250 ditë në vit.

- Si mund të justifikosh periudhën që nuk ke pulla ditësh sigurimi (sigurimi në IKA) (par. A1 Y.A.15055/546, Fleta e Gazetes Zyrtare t. B´ 1886/25.8.2011)

- Me kartën e papunësisë ose vërtetimin e Organizmit të Punësimit të Potencialit Punëtor – **OAED** për periudhën e papunësisë.

- Me raport mjekësor nga Spital Shtetëror ose nga Arkë Siguruese.

- Arsye të tjera të fuqive të mbinatyrshme (shtatzënie, lindje fëmije, dëshmitar në gjyq etj).

Në çdo rast, për të siguruarit në IKA kërkohen 50 pulla ditësh sigurimi/vit ose 100/dyvjeçar.

-E drejta e blerjes së pullave të sigurimit

Në qoftë se edhe pas përlogaritjes së ditëve të justifikuara të largimit nga puna, numri i pullave të sigurimit është i pamjaftueshëm, atëherë numri që mungon mund të blihet, përderisa nuk tejkalon 20% të numrit të kërkuar të pullave të sigurimit.

Mundësia e blerjes së pullave të sigurimit për të siguruarit në OGA nuk ekziston.

SHEMBULL 1

Mbajtesi i lejes së qëndrimit për dy vjet për punë të varur (neni 15 par. 1-4 i ligjit 3386/05) ka brenda dyvjeçarit të afatit të lejes së tij: 60 muaj periudhë papunësie dhe 150 pulla sigurimi.

Gjashtë muajt e papunësisë duhet të zbriten nga 600 ditët e punës (të dyvjeçarit), rrjedhimisht ndjekim arsyetimin e mëposhtëm, duke zbatuar mënyrën e thjeshtë të “përpjesëtimit të drejtë”:

Në 600 ditët e punës kërkohen 240 pulla sigurimi, në 450 ditë, sa duhen? $(450 \times 240 : 600 =)$ 180 pulla sigurimi. I lartpërmenduri ka 150 pulla, domethënë mund të blejë 30 të tjerat që mungojnë (pasi 20% e 180 janë 36 pulla).

SHËNIME TË VLEFSHME

- Tashmë Administratat e Decentralizuara (ish Prefekturat) kanë mundësi hyrjeje direkte tek llogaria e të siguruarit, kështu që nuk kërkohet paraqitja e pullave të sigurimit tek Bashkia.
- Pavarësisht nga fakti se ke dhe sa pulla mungojnë, Bashkia jep vërtetimin blu.
- Në rast denoncimi për njohje ditësh sigurimi në Ika, leja e qëndrimit do të jepet përderisa është botuar Akti i Imponimit të Kontributeve kundër punëdhënësit.
- Në rast ndryshimi të llojit të punës dhe subjektit siguroes gjatë kohës së rinovimit të lejes së qëndrimit, llogaritet totali i ditëve të sigurimit të çdo subjekti.
- Në qoftë se ndryshon llojin e punës, pa bërë informimin përkatës në Bashki, imponohet gjობë, por nuk shfuqizohet leja e qëndrimit.

Për informacione analitike mund të vizitosh faqet e internetit www.mighelp.net dhe www.ypes.gr

Μέσο për pullën e punës – Informo punëdhënësit e tu¹

Me pullën e punës paguhesh dhe sigurohesh me një lëvizje

Pulla e punës (çeku) përmban pagesën e rënë dakord midis punëdhënësit me punonjësit. Në të përfshihet edhe shuma për sigurimin tënd.

NUK KE TË DREJTËN TË KESH VETËSIGURIM (BLLOK) SI MË PARË.

Me pullën e punës paguhesh detyrimisht:

A. Përderisa punon në shtëpinë e punëdhënësit (shërbime shtëpie, pastrimi dhe kopshtarie të territoreve të përbashkëta të pallateve, ruajtjes së fëmijëve dhe të moshuarve, shërbime kopshtarie, shoferi, trajtimi ose kujdesi si infermier i të sëmurëve, shërbime riparimesh të vogla që nuk janë punë ndërtuese, mësimesh ndihmëse, permanentit dhe kujdesit të fytyrës dhe trupit) dhe nuk bën pjesë në personelin e biznesit.

B. Përderisa je shpërndarës i teksteve reklamuese, i punësuar në shitjen e produkteve të fytyrës dhe trupit shtëpi më shtëpi ose në vend tjetër ose të produkteve konsumuese në dyqane me shumë departamente, në dyqane ushqimesh dhe në super-market.

C. Përderisa je punëtor toke dhe je i siguruar në OGA.

Duhet të informosh punëdhënësin tënd (në qoftë se nuk e njeh) për mënyrën e pagesës tënde.

Punëdhënësi është i detyruar nga ligji të të paguajë me pullën e punës. Më konkretisht: me lëshimin e pullës së posaçme të punës në formën e çekut, nëpërmjet llogarive që kanë punëdhënësi dhe punonjësi në banka, me depozitim dhe arkëtim parash në dorë në banka – Postën Hellene (ELTA) dhe me mandapostë të posaçme.²

Shumica e bankave kanë aplikuar procedura për lehtësimin e punëdhënësve. Procedura mund të bëhet qoftë me prezencën fizike, qoftë nëpërmjet shërbimeve të internetit ose akoma edhe nëpërmjet telefonit.

Punëdhënësi ka mundësinë të marrë formularin për pullën e punës nga: subjektet e sigurimeve shoqërore, nga bankat, Posta Hellene, nga Qendrat e Shërbimit të Qytetarëve (KEP).

Në qoftë se paguhesh me pullën e punës 2/3 e shumës që shkojnë për kontributet siguroese, zbriten nga të ardhurat e tij të tatueshme. Pjesa tjetër 1/3 zbritet nga të ardhurat e tua.

Llogaritja e pullave që i korrespondojnë pullës së punës.

Nga shuma totale e pullës së punës (IKA) 25% shkon direkt për sigurimin tënd. Me qëllim që të llogaritësh sa pulla ke të drejtë të marrësh, duhet të bësh llogaritjen e mëposhtme:

Shembull për pullë pune 400 euro:

Për pullë pune 400 € kontributet në IKA janë 100 € (400 euro X 25% = 100 € kontribut në IKA)

100 € (kontribut në IKA) : 11,88 (koeficient konstant³) = 8,41 ditë sigurimi (pulla).

Për cilët muaj korrespondojnë pullat nga pulla e punës:

Pullat e punës u korrespondojnë ditëve të sigurimit të muajit brenda të cilit konvertohen. Domethënë nuk parashikohet mundësi për pagesën e kontributeve siguroese për muajt e kaluar.⁴

Pavarësisht nga shuma që arkëtohet, punonjësi mund të marrë deri në 25 pulla në muaj ose 300 në vit.

¹ Broshura ka të bëjë me pullën e punës që i takon Institutit të Sigurimeve Shoqërore (IKA). Informacione për pullën e punës që i takon OGA-s mund të gjelesh në faqen e internetit www.mighelp.net

² Për punëtorët e tokës, të siguruar në OGA, pulla e punës paguhet tani për tani vetëm në Postën Hellene (ELTA).

³ 33,57 (Dita e punës e punëtorit të pakualifikuar, siç ishte në fuqi në datën 31.12.2011) X 35,40 (shuma e sigurimit) = 11,88 (numër konstant në çdo rast).

⁴ Me përjashtimin e kontributeve të vitit 2012 në OGA, shiko shkresën e OGA 2/2013 dhe 4/2013

Ekzistojnë rregullime të posaçme për fëmijët e emigrantëve të ligjshëm që lindin ose/dhe rriten në Republikën Hellene.

Mund ti shikosh në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Lloji i lejes	Predispozita	Kuota (Paravolo)	Afati - Rinovimi	Vërejtje
Bashkim familjar U jepet fëmijëve të emigrantëve të ligjshëm për aq sa ata janë të mitur.	Të jetë i ligjshëm të paktën një nga prindërit e tu dhe të bëjë kërkesë në Bashki.	Falas	Afati: i barabartë me kohën e lejes së prindit që rëndohet deri sa të bëhet madhor.	Emigrantët e ligjshëm mund të bëjnë kërkesë për fëmijët e tyre që kanë lindur në Republikën Hellene në cilindo moment para se të bëhen madhorë. Por vonesa në dorëzimin e kërkesës sjell për pasojë gjobë.
I pavarur U jepet fëmijëve të emigrantëve të ligjshëm pasi janë bërë madhorë.	Të kishë më parë leje për bashkim familjar. Të kesh sigurim nga subjekt sigurues (edhe privat) për shpenzime mjekimi dhe trajtimi mjeko-farmaceutik.	150 euro	Afati: 1 vit Mund ta rinovosh çdo vit deri në moshën 21 vjeç, me të njëjtat predispozita që u lëshua fillimisht.	Ke të drejtën e punës me rrogë Në qoftë se kishë leje bashkë me prindërit e tu dhe pas moshës 18 vjeç largohesh nga Republika Hellene me qëllim që të shkosh ushtar ose të studiosh në Universitet, mund të kthehesh në Hellas, përderisa ke kryer ushtrinë ose ke përfunduar studimet e tua respektivisht dhe përderisa prindërit e tu ose prindi vazhdojnë të qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në Hellas. Atëherë duhet të marrësh vizë të posaçme hyrjeje dhe të bësh kërkesë brenda 6 muajve nga përmbushja e detyrimeve ushtarake ose nga marrja e diplomës, me qëllim që të marrësh leje të re qëndrimi me afat për 1 vit, duke paguar kuotë (paravolo) 150 euro. Në vazhdim duhet të rinovosh për një nga qëllimet e tjera të ligjit 3386/05.
Studime U jepet fëmijëve të emigrantëve që hyjnë në Institucione të Larta Arsimore (Universitete) – Institute Teknologjike Arsimore (AEI-TEI) ose studiojnë në Institute të Trajnimit Profesional (IEK) dhe Kabinete të Studimeve të Lira.	•Hyrje në Institucione të Larta Arsimore (Universitete) – Institute Teknologjike Arsimore (AEI-TEI) •Regjistrim në Institute të Trajnimit Profesional (IEK) dhe Kabinete të Studimeve të Lira	150 euro	Afati : 1 vit Rinovim për aq kohë sa është akoma student – nxënës.	Ke të drejtën për punë me orar të shkurtuar pas dhënies së miratimit Pas përfundimit të studimeve ke të drejtën të marrësh leje të pavarur qëndrimi për një vit, e cila rinovohet vetëm për një nga qëllimet e tjera të ligjit 3386/05.
Arsye humanitare U jepet madhorëve të lindur në Republikën Hellene ose atyre që kanë mbaruar të paktën gjashtë klasa shkollash hellene para se të bëhen madhorë	•Akt civil të lindjes ose vërtetim për gjashtë klasa shkolle •Dokumente zyrtare që vërtetojnë qëndrim të ligjshëm në Republikën Hellene	150 euro	Afati : 1 vit NUK RINOVOHET	Ke të drejtën e punës me rrogë Pas përfundimit të lejes së qëndrimit duhet ta rinovosh për një nga qëllimet e tjera të ligjit 3386/05. Dorëzimi i kërkesës bëhet vetëm në Ministrinë e Brendshme.
Leje qëndrimi me afat të gjatë (Ligji. 3731/08) U jepet fëmijëve madhorë të emigrantëve të ligjshëm që kanë lindur në Republikën Hellene	•Të kesh dëftesë lirim të shkollës fillore ose gjimnazit Hellen •Të jenë prindërit e tu (përderisa janë gjallë) të ligjshëm në vendin tonë	600 euro	Afati : 5 vjet Për rinovimin paraqet fotokopje të pasaportës dhe të lejes së mëparshme të qëndrimit me afat të gjatë Pa kuotë (paravolo)	Nuk të jep të drejtën e punës në shtet tjetër – anëtar të BE-së Që të inkuadrohesh në regjimin e lejes së qëndrimit me afat të gjatë sipas ligjit 3386/05 duhet të përmbushësh predispozitat respektive. Për dorëzimin e kërkesës, nuk kërkohet të kesh leje qëndrimi në fuqi.

Certifikimi i njohurive të gjuhës, historisë dhe kulturës për emigrantët me rezidencë të gjatë

Predispozitë e domosdoshme që të fitosh lejen e qëndrimit afatgjatë është të njohësh gjuhën hellene, historinë dhe kulturën.

Kjo vërtetohet me mënyrat e mëposhtme:

- me dëftesën e lirit të paktën të arsimit të detyrueshëm të shkollave hellene në Republikën Hellene.
- me dëftesën e pjekurisë të shkollave të mesme (liceut) të vendeve të huaja, të cilat i përkasin sistemit arsimor hellen.
- me titull të njohur të përfundimit të degëve të gjuhës hellene të Universiteteve të Huaja.
- me vërtetimin e njohjes së gjuhës hellene të nivelit të paktën B1 që lëshohet sipas dekretit presidencial 60/2010 dhe
- me certifikatë të posaçme të njohjes së mjaftueshme të gjuhës hellene dhe të elementeve të historisë hellene dhe kulturës pas provimit të suksesshëm që bëhet me përgjegjësinë e Sekretarisë së Përgjithshme të Mësimit të Përrjetshëm në bashkëpunim me Qendrën e Gjuhës Hellene, në kuadrin e kompetencave të saj për certifikimin e njohjes së gjuhës hellene.

Provime për fitimin e vërtetimit të njohjes së mjaftueshme të gjuhës hellene dhe elementeve të historisë hellene dhe kulturës

Për rastet e pikave d dhe e duhet të japësh provime.

Qendrat e gjuhës hellene

Për lëshimin e certifikatës së njohjes së gjuhës hellene të nivelit të paktën B1, subjekt kompetent është Qendra e Gjuhës Hellene. Organizon provime për të gjitha nivelet e mësimit të gjuhës hellene të paktën 2 herë në vit. Informacione tek faqja e internetit: <http://www.greeklanguage.gr/certification>

Sekretaria e Përgjithshme e Mësimit të Përrjetshëm

Për fitimin e certifikatës së posaçme duhet të japësh provime në nivelin A2 të gjuhës hellene dhe në tema të historisë dhe kulturës në data që përcaktohen nga Sekretaria e përgjithshme e Mësimit të Përrjetshëm (prill dhe tetor). Në qoftë se ke fituar certifikimin e nivelit A2 (niveli A para vitit 2010) mund të japësh provim vetëm për tema të historisë dhe kulturës.

Për informacione në faqet e internetit: www.gsae.edu.gr dhe www.inedivim.gr

Për pjesëmarrjen në provime derdhet kuotë (paravolo)

Mësime të gjuhës hellene

Mësimet nuk janë të detyrueshme me qëllim që të kesh të drejtën të japësh provime. Por është mirë të përgatitesh. Mësime bëhen nga grupe vullnetare, shoqëri joqeveritare, Qendra të Trajnimit Profesional dhe organizma të tjerë arsimorë. Shumë janë falas, ndërsa në të tjera duhet të paguash.

Institucioni i Rinisë dhe i Mësimit të Përrjetshëm organizon programin "ODYSSEAS", i cili ofron mundësitë për mësime në mbarë Republikën Hellene (informacione në telefonat 2131311592 dhe 2131311580).

* Nivele të reja të mësimit të gjuhës hellene

Me Dekretin Presidencial 60/30-06-2010 (Fleta e Gazetës Zyrtare 98), u institucionalizuan 2 nivelet e reja A1 (A1 për fëmijë nga moshja 8 deri në moshën 12 vjeç dhe A1 për adoleshentë dhe të rritur) dhe Γ2 dhe u quajtën nivelet aktuale si më poshtë: A = A2, B=B1, Γ = B2, Δ=Γ1.



Shtetësia për qytetarë të shteteve të treta

Në qoftë se je qytetar i një shteti të tretë dhe banon në mënyrë të ligjshme në vendin tonë, ke të drejtën të bësh kërkesë për të fituar shtetësinë hellene.

Shteti Hellen, sipas predispozitave të ligjit, do të vendosë në qoftë se ke të drejtën të bëhesh qytetar hellen.

Koha e lejes së mëparshme të qëndrimit

1. Shtatë vjet, në qoftë se je emigrant i ligjshëm dhe disponon leje qëndrimi afatgjatë sipas ligjit 3386/051.¹
2. Tre vjet, në qoftë se je bashkëshort i qytetarit hellen ose qytetares hellene me fëmijë, ose ke kujdestarinë e fëmijës, përderisa nuk ka fituar shtetësinë për arsye studimi neni 1a par. 2 i ligjit 3838/10.
3. Nuk ka nevojë të vërtetosh qëndrimin e ligjshëm të mëparshëm, në qoftë se je homogjen ose ke lindur në Republikën Hellene.

Kur ke të drejtën të bëhesh qytetar Hellen

- a. përderisa je i rritur
- b. përderisa nuk je dënuar në formë të prerë për një sërë aktesh të dënueshme (mund të shikosh se cilat janë këto në nenin 2 të ligjit 3838/10) dhe nuk je në regjim dëbimi.
- c. përderisa ke leje të ligjshme qëndrimi në fuqi (jo vërtetim ose kartë rozë).*

Më konkretisht:

- 1) leje qëndrimi afatgjatë sipas dekretit presidencial 150/2006 (Fleta e Gazetës Zyrtare 160 A'),
- 2) kartë ose titull tjetër qëndrimi që lëshohet tek pjesëtarët e familjes së qytetarit Hellen ose qytetarit të shtetit – anëtar të Bashkimit Evropian ose tek prindërit e fëmijës së mitur vendase.²

Ç' farë duhet të vërtetosh në intervistën ku do të thirresh para komisionit:³

- a. se njeh në mënyrë të mjaftueshme gjuhën hellene.
- b. se je integruar normalisht në jetën ekonomike dhe shoqërore të Vendit.
- c. se ke mundësinë të marrësh pjesë në mënyrë aktive dhe esenciale në jetën politike të Vendit, duke respektuar parimet themelore që e përshkojnë atë.

Kuotë (paravolo) 700 euro (për dorëzimin fillestar të kërkesës), 200 euro (për ridorëzimin)

INFORMACIONE TË VLEFSHME

- Në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme (http://www.ypes.gr/el/Generalsecretariat_PopulationSC/general_directorate_migration/diefthinsi_metanastefikis_politikhs/) mund të gjesh në formë të printueshme libër për çështjet e historisë, gjeografisë dhe kulturës, që eventualisht mund të të pyesin në intervistë.
- Nuk ekziston për momentin procedurë e posaçme për fëmijët që kanë lindur në Republikën Hellene ose kanë studiuar në Sistemin Arsimor Hellen .
- Që të fitosh shtetësinë hellene duhet të japësh betimin brenda një viti nga data e botimit të vendimit respektiv të fitimit.

Për informacione analitike mund të vizitosh faqet e internetit www.mighelp.net dhe www.ypes.gr

¹ Në qoftë se ke mbushur 5 vjet qëndrimi të ligjshëm para botimit të ligjit 3838/10, mund të bësh kërkesë për marrjen e shtetësisë pavarësisht nga leja e qëndrimit që ke, ² Në qoftë se je homogjen, refugjat etj duhet të kesh lejet respektive të qëndrimit, ³ Mund të dorëzosh në komision edhe dokumente, të cilat merren parasysh për vendimin e komisionit

Νέοι φοιτητές σε je viktimë e dhunës raciste, mund ta denoncosh në Polici, në të cilën funksionon Shërbim i posaçëm me këtë objekt

Funksionojnë (2) dy Seksione të Përballimit të Dhunës Raciste dhe gjashtëdhjetë e tetë (68) Zyra të përballimit të Dhunës Raciste në të gjithë vendin.

Seksionet koordinojnë dhe udhëheqin Zyrat e Përballimit të Dhunës Raciste të Seksioneve të Policisë të Drejtorisë përkatëse të Policisë për përmbushjen e misionit të tyre.

Çfarë mund të bësh në qoftë se je viktimë ose ka rënë në dijeninë tënde incident i dhunës raciste:

- Të denoncosh nëpërmjet telefonit në numrin 11414 (funksionon gjithë njëzet e katër orëshin) incidentin e dhunës raciste.
- Të denoncosh nëpërmjet faqes së posaçme të internetit www.ydt.gr
- Të denoncosh incidentin në Seksionet ose në Zyrat kompetente.
- Të informohesh për të drejtat e tua nga Seksionet ose nga Zyrat kompetente.



Ειδική τηλεφωνική γραμμή καταγγελιών
11414
(Λειτουργεί όλο το 24ωρο)
Διασφαλίζεται το ανώνυμο και απόρρητο της επικοινωνίας

Linjë e posaçme telefonike e denoncimeve
11414
(funksionon gjithë 24orëshin)
Sigurohet anonimia dhe sekreti i komunikacionit

Gjithashtu mund ti drejtohesh Rrjetit të Regjistrimit të Dhunës Raciste (www.nchr.gr) ose Subjekteve që marrin pjesë në të.

- | | |
|--|---|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. COLOUR YOUTH- KOMUNITETI LGBTQ I TË RINJVE I ATHINA 2. i-red 3. PRAKSIS 4. YsMEDIA 5. AITHMA 6. ANTIGONI 7. ARSIS 8. MJEKËT E BOTËS (GIATROI TOU KOSMOU) 9. AMNISTIA NDËRKOMBËTARE (DIETHNIS AMNISTIA) 10. RRJETI I PËRKRAHJES SOCIALE TË REFUGJATËVE DHE EMIGRANTËVE (DIKTYO YPOSTIRIKSIS PROSFYGMON DHE METANASTON) 11. BASHKIMI HELLEN I TË DREJTAVE TË NJERIUT (ELLINIKI ENOSI GIA TA ANTHROPINA DIKEOMATA) 12. VROJTUESI HELLEN I MARRËVESHJEVE TË HELSINKIT (ELLINIKO PARATIRITIRIO TON SYMFONION TOU ELSINKI) 13. KËSHILLI HELLEN PËR REFUGJATËT (ELLINIKO SYMVOULIO GIA TOUS PROSFYGES) 14. FORUMI HELLEN I EMIGRANTËVE (ELLINIKO FORUM METANASTON) 15. FORUMI HELLEN I REFUGJATËVE (ELLINIKO FORUM PROSFYGMON) 16. KRYQI I KUQ HELLEN (ELLINIKOS ERYTHROS STAVROS) 17. KOMISIONI I TË DREJTAVE TË NJERIUT I SHOQATËS SË AVOKATËVE TË RODHOS (EPITROPI ANTHROPINON DIKEOMATON TOU DIKIGORIKOU SYLLOGOU RODOU) 18. NDËRHYRJA MJEKËSORE (IATRIKI PAREMVASI) 19. QENDRA E DITËS VAVEL (KENTRO IMERAS VAVEL) 20. LËVIZJA E MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË REFUGJATËVE DHE EMIGRANTËVE (KINISI YPERASPISIS TON DIKEOMATON PROSFYGMON KE METANASTON/STRION) | <ol style="list-style-type: none"> 21. BOTA PA LUFTËRA DHE DHUNË (KOSMOS HORIS POLEMOS KE VIA) 22. LATHRA - KOMISION I SOLIDARITETIT PËR REFUGJATËT E HIOS (LATHRA – EPITROPI ALLILEGGYIS STOUS PROSFYGES HIΟΥ) 23. METAdrasi – VEPRIMTARI PËR EMIGRACIONIN DHE ZHVILLIMIN (METAdrasi – DRASI GIA TIN METANASTEFSI KE TIN ANAPTYKSI) 24. PROGRAM UNIVERSAL I REFUGJATËVE (IKOUMENIKO PROGRAMA-PROSFYGMON) 25. GRUPI I AVOKATËVE PËR TË DREJTAT E REFUGJATËVE DHE EMIGRANTËVE (OMADA DIKIGORON GIA TA DIKEOMATA PROSFYGMON KE METANASTON) 26. GRUPI I MBËSHTETJES LIGJORE TË EMIGRANTËVE DHE REFUGJATËVETË THESSALONIKI (OMADA NOMIKIS STIRIKSIS METANASTON KE PROSFYGMON THESSALONIKIS) 27. KOMUNITETI HOMOSEKSUAL DHE LEZBIK I HELLAS (OLKE) (OMOFYLOFILIKI KE LESVIKI KINOTHTA TIS ELLADOS) 28. SHOQATA E AFGANËVE TË BASHKUAR (SYLLOGOS ENOMENON AFGANON) 29. AVOKATI I POPULLIT (SYNOGOROS TOU POLITI) 30. FORUMI I EMIGRANTËVE TË KRITIS (FORUM METANASTON KRITIS) |
|--|---|

